



## **Karta e Angazhimi për Anëtarësim në Aleancën Parlamentare kundër Urrejtjes**

Strasbourg, 29.1.2015

Duke kujtuar Rezolutën e Asamblesë Parlamentare 1967 (2014) mbi një strategji për të parandaluar racizmin dhe intolerancën në Evropë dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave (97) 20 kundër gjuhës së urrejtjes;

Duke përshëndetur aktivitetet e fushatës së "Lëvizjes kundër Gjuhës së Urrejtjes" dhe duke pranuar rëndësinë e punës së kryer nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës;

Duke pasur parasysh se gjuha e urrejtjes dhe manifestimet e racizmit dhe intolerancës, pavarësisht shkakut, përbëjnë një problem serioz që prek të gjitha vendet e Evropës dhe të gjitha nivelet e shoqërisë;

Duke pohuar që gjuha e urrejtjes dhe manifestimet e intolerancës, për asnjë arsye nuk janë në përputhje me respektimin e vlerave themelore të Këshillit të Evropës dhe duhet të dënohen;

Duke shprehur shqetësimin se kriza ekonomike dhe financiare krijon terren pjellor për rritjen e gjuhës së urrejtjes, racizmit dhe intolerancës, të cilat tashmë janë të pranishme në shoqëri;

Duke u bazuar në parimet e Kartës së partive politike evropiane për një shoqëri joraciste, hartuar nën kujdesin e Komisionit Konsultativ të Bashkimit Evropian për Racizmin dhe Ksenofobinë dhe duke inkurajuar zbatimin e saj;

Duke qenë të bindur për rolin vendimtar të luajtur nga politikanët në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, racizmit dhe intolerancës;

Duke marrë funksionin e anëtarëve të *Aleancës Parlamentare kundër Urrejtjes* dhe përmes nënshkrimit të kësaj Karte, ne angazhohemi të:

- mbajmë qëndrime të hapura, të forta dhe proaktive kundër racizmit, urrejtjes dhe intolerancës për çdo arsye;
- promovojmë mosdiskriminimin dhe respektimin e diversitetit, si të bazuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj;
- rrisim ndërgjegjësimin kundër racizmit dhe intolerancës midis politikanëve dhe shoqërisë civile, në nivel kombëtar dhe evropian;
- zhvillojmë fushata kundër racizmit, urrejtjes dhe intolerancës me të gjitha mjetet, duke përfshirë mediat sociale, në bashkëpunim me parlamentet kombëtare, në nivel kombëtar edhe në nivel evropian;
- shkëmbejmë informacion mbi ligjin dhe praktikatat më të mira për parandalimin dhe luftimin e racizmit, urrejtjes dhe intolerancës me parlamentarët e vendeve të tjera;
- mbështesim dhe të marrim pjesë në punën e komiteteve kombëtare të Këshillit të Evropës "Lëvizja kundër fjalës së urrejtjes".